REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr._____, Prot. Tiranë, më ___.___.___

**VENDIM**

**Nr. 421, datë 14.10.2022**

**PËR**
**SKUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {…},**
**PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,**
**PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQTAR, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 14.10.2022, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin "Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {…}", përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatit z. {…} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2021-2022,

**VËREN**

## I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {…} është kandidat për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 15.04.2021, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit dhe është përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 14.05.2021, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr. 365/1 prot., datë 14.05.2021 (protokolluar në Këshill me aktin nr. 2222 prot., datë 14.05.2021).

2. Me Vendimin nr. 218, datë 26.05.2021, mbështetur në nenin 32 të Ligjit për Statusin, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë" (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur *fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022*, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit *për kandidatin z. {...} si relator u caktua z. Alban Toro.*

3. Më datë 26.05.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z.{…}, në rrugë elektronike, u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditor, kandidati, z.{…}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 01.06.2021, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidatit, z.{…}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati, z.{…}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 21 ditor (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin "Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë" pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 07.06.2021, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të

Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z.{…}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidati në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e tij në punë (punësimin), si dhe në ato të marra nga organet e sigurimeve shoqërore (me Shkresën nr. 3692/1 prot., datë 14.06.2021, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z.{…}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

10. Pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin {…}, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, më datë 07.12.2021, relatori e parashtroi çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës e shqyrtoi çështjen më datë 07.12.2021 dhe, pasi vlerësoi të plotë procedurën e verifikimit në këtë rast, bazuar në pikën 3, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, vendosi kalimin e saj për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin ose skualifikimin e kandidatit {…} për në formimin fillestar për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës.

## II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

### A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

12. Sa i përket kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidatin {…}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30[1] ("Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i

[1] *"1. Shkolla e Magjistraturës pranon aplikimet për pranimin në formimin fillestar, deri në fund të muajit shkurt të çdo viti. 2. Kandidatët paraqesin dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kritereve të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk vërteton plotësisht përmbushjen e kritereve, nuk është i*

kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 15.04.2021, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {…}.

13. Gjithsesi, për kandidatin {…}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

13.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2021), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kritereve nga ana e tyre (Prill 2021), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet te shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2021). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kritereve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

13.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”), pika 4/1[2], shkronja “ç”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkaku përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kritereve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i

---

*plotë, i saktë, ose ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e tij, Shkolla e Magjistraturës mund të kërkojë informacion ose dokumentacion shtesë nga organet publike ose punëdhënësit e kandidatit. 3. Deri në datën 15 mars të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës kryen një vlerësim paraprak, nëse kandidati përmbush kriteret e kandidimit, të parashikuara në nenin 28 të këtij ligji. 4. Shkolla e Magjistraturës i paraqet Këshillave raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat. Këshillat mund të japin komente ose kundërshtime jo më vonë se në fund të muajit mars të çdo viti. Shkolla e Magjistraturës miraton raportin e vlerësimit përfundimtar, duke marrë në konsideratë komentet dhe kundërshtimet e bëra, dhe publikon raportin e vlerësimit përfundimtar në faqen e saj zyrtare, duke përfshirë listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 28 të këtij. 5. Çdo kandidat, i cili nuk është përfshirë në listën e kandidatëve, të cilët plotësojnë kriteret, ka të drejtë të ushtrojë mjetet ligjore të ankimit, të parashikuara në ligjin "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" dhe aktet nënligjore përkatëse”.*

[2] *“4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur: ...; ç) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit”.*

Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

14. Konkretisht, për kandidatin u verifikua:

*a) zotësia e plotë për të vepruar.* Për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

*b) shtetësisë shqiptare.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentin "kartë identiteti", lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 13.03.2019, në të cilin përbërësi i gjendjes civile "shtetësia", pasqyrohet "shqiptare", ndërkohë që gjatë verifikimit për kandidatin nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen e shtetësisë shqiptare. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 23.06.2021, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

*c) gjendja gjyqësore.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) duke printuar në letër Certifikatë Elektronike datë 05.02.2021, ndërkohë që gjatë verifikimit, në kuadër të verifikimit të figurës së kandidatit, u administrua Shkresa nr. 6269/1 prot., datë 17.06.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk ka shënime në sistem;

*ç) disiplina në punë.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin "Librezë Pune" lëshuar më datë 07.11.2008, ndërkohë që gjatë verifikimit u administruan Shkresa me nr. 1058/1 prot., datë 17.06.2021, e Agjencisë Shtetërorë të Kadastrës, Tiranë dhe Shkresa me nr. 2937/1 prot., datë 16.06.2021 e ILDKPKI. Sipas këtyre dokumenteve kandidati nuk është i larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ai nuk ka masë disiplinore në fuqi;

*d) mosqenia bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë më datë 04.02.2021 në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që gjatë verifikimit nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

15. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

*a) pasjen e kriterit arsimor.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar dokumentet: "Diplomë në Drejtësi", me nr.5546, datë 10.07.2008, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë Universiteti i Tiranës si dhe Certifikatë Notash datë 12.07.2008;

*b) pasjen e përvojës profesionale.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës kandidati ka depozituar dokumentin "Librezë Pune", sipas të cilit kandidati, pas përfundimit të studimeve universitare në drejtësi, ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në administratën publike, konkretisht si "Specialist/Jurist /Inspektor/ Zv. regjistrues/përgjegjës", për periudhën 7 nëntor 2008 – 01 nëntor 2013 pranë Agjencisë Shtetërorë të Kadastrës (ish Drejtoria Vendore dhe Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme), si "Specialist" për periudhën 28 shkurt 2014– 23 qershor 2014 pranë ILDKPKI, si "Specialist/ Drejtor" për periudhën 18 dhjetor 2017 – 06 qershor 2019 pranë ALUIZNI zyra qendrore dhe vendore Shkodër dhe si "Specialist në sektorin e marrëdhënie me publikun" për periudhën 06 qershor 2019 – e në vijim pranë Agjencisë Shtetërorë të Kadastrës;

*c) mos anëtarësinë në parti politike në kohën e kandidimit.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në datë 04.02.2021 në të cilën deklaron se nuk është anëtar i ndonjë partie politike;

*ç) mosqenien anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990.* Në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë në datë 04.02.2021, në të cilën deklaron se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, përveç se referuar moshës së tij (i datëlindjes 27.01.1985), ai nuk mund të ketë qenë i tillë.

16. Nga sa rezulton nga verifikimi, kandidati {…} plotëson kriteret e kandidimit si gjyqtar, sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit.

**B. Për kriterin e pasurisë**

17. Për kandidatin {…} u kryen disa nga procedurat për verifikimin e kriterit të pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *"1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të pasurisë …".*

18. Në këtë kuadër u administruan për kandidatin {…}, raportet nga institucionet publike kompetente të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit. Këto raporte, krahas kandidatit, u kërkuan edhe për bashkëshorten e tij, znj. {…}, si person i lidhur me të në kuptim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar (nenet 3 dhe 5), si dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar (neni 2).

19. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {…}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 512/23 prot., datë 17.09.2021.

19.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidati {…} dhe personi i lidhur me të, kanë plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë dhe interesave privatë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

19.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit është kryer kontrolli i plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë të deklaruara nga kandidati {…} dhe personi i lidhur me të, duke konkluduar se për kandidatin:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

19.3 Referuar rezultateve të kontrollit të plotë për pasuritë, asetet dhe interesat privatë dërguar nga ILDKPKI për kandidatin z.{…}, Relatori, më datë 29.09.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar disa pyetje si vijon, *...omissis..* "*Referuar kontrollit të pasurisë dërguar nga ILDKPKI pranë Këshillit, lutemi nga ana Juaj të jepni shpjegim në lidhje me disa prej pikave të referuara nga kontrolli i bërë në lidhje me; 1.Periudhën 2015-2016 ku figuron se keni përfituar sigurime jetese nga qendra e punës në Berlin me vlerë 8.862 euro, kjo periudhë që përkon me të ardhurat në vlerë totale 24.311 paund nga M. Bashkuar për periudhën 2015-2019. 2. Për periudhën 2017 si i punësuar në kompaninë Alban travel LTD është i pa qartë dokumentacioni për periudhën 2015-2017, referuar pikës 1 del viti 2019?? Referuar më sipër ju lutem na mundësoni në rend kronologjik të periudhave të qarta të punësimit tuaj brenda dhe jashtë vendit për të kuptuar qartë periudhat e mbivendosura të punësimit si dhe të ardhura të përfituara nga zyrat e ndihmës sociale*." *...omissis.*

19.4 Në përgjigje të këtyre pyetjeve z.{…} më datë 30.09.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar sqarime dhe dokumente shoqëruese si vijon: *"Në lidhje me shpjegimet e kërkuara nga ana juaj, mbi raportin e ILDKPKI, ju sqaroj se: 1.Kam filluar punë për herë të parë në Zyrën Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme me datë 07.11.2008, ku kam punuar në pozicione të ndryshme deri me datë 01.11.2013, ndërkohë në vitet 2011, 2013 kam punuar me kohë të pjesshme në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si trajnues. 2. Nga data 28.02.2014 - 23.06.2014 kam punuar në pozicionin e specialistit pranë ILDKPKI, ndërkohë që kam punuar edhe si pedagog i jashtëm në Universitetit e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë. 3. Më datë 27.01.2015 jam larguar në Gjermani, Berlin. Menjëherë jam paraqitur pranë zyrave të punës si punëkërkues si dhe kam kërkuar ndihmë sociale/financiare meqenëse kostoja e jetesës ishte e papërballueshme nga ana ime. Nga ana e autoriteteteve gjermane mu kërkuan kualifikimet universitare dhe pasuniversitare me qëllim që puna që do më sigurohej duhej të përshtatej me profilin tim. Nga ana ime, pranë këtyre zyrave është depozituar dokumentacioni i përkthyer dhe i noterizuar, si diploma e Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe eksperienca ime e punës. Kërkesa ime për ndihmë sociale/financiare u miratua duke filluar nga data 1 Mars 2015 për një afat 1 vjeçar, me përtëritje çdo 6 muaj ose sipas rastit edhe çdo muaj. Në total kam përfituar ndihmë sociale nga 1 Mars 2015 deri në 28 Shkurt 2016 në shumën totale prej 8.862 euro. Sa më sipër vërtetohet me vendimet e zyrës së punës së Berlinit bashkëlidhur deklaratës së pasurisë depozituar në ILDKPKI. Krahas miratimit të ndihmës sociale/financiare, kjo zyrë u angazhua gjithashtu për gjetjen e një pune sipas profilit ose të përshtatshme me të, me kushtin e mësimit të rrjedhshëm të gjuhës gjermane. Gjatë periudhës së qëndrimit tim në Gjermani nuk mu ofrua asnjë pozicion pune nga ana e autoriteteve zyrtare gjermane, dhe kërkimet e mia në tregun e punës ishin të pasuksesshme kryesisht për shkak të mosnjohjes së gjuhës gjermane në nivelin e duhur. Në rrethana të tilla, si dhe të një pasigurie mbi të ardhmen e një punësimi në Gjermani, jam paraqitur pranë zyrës së punësimit duke i njoftuar për largimin tim të përkohshëm drejt qytetit të Londrës (Angli) në kërkim të një pune të përshtatshme. Nga kjo zyrë mora inkurajimin për vazhdimin e kërkimit të një pune si në Gjermani, ashtu edhe në vende të tjera të BE, ndërsa procedura e kërkimit të punës sipas profilit do të vazhdonin nga ana e tyre. Dëshiroj të sqaroj se zyra e punësimit e qytetit të Berlinit ka pasur akses të plotë për monitorimin e gjendjes sime të punësimit si në Gjermani apo në vendet e tjera të BE, si dhe daljen jashtë territorit Gjerman në Tetor të vitit 2015 drejt Londrës, konform të gjitha rregullave të kalimit kufitar. 4. Ndërkohë që isha në kërkim të një punë të përshtatshme si në Angli ashtu dhe në Gjermani (duke zhvilluar intervista pune në të dyja shtetet), për arsye të kostos së lartë të jetesës më datë 10.10.2015 kam filluar punë me kohë të pjesshme pranë kompanisë Turtle Bay Restaurants Ltd, Londër, punë që ka vijuar deri me datë 13.05.2016, duke siguruar të ardhura në shumën 7048 paund, bashkëlidhur do të gjeni P60 (certifikata e fund vitit), lëshuar nga kjo kompani. Meqenëse, në fund të Shkurtit/2016, nuk dukej një vizion i qartë punësimi në shtetin Gjerman, nuk është bërë më kërkesë nga ana ime për përtëritje të ndihmës sociale/financiare për vitin në vazhdim. Në rrethana të tilla, jam zhvendosur përfundimisht në Londër, duke filluar punë menjëherë (punë të dytë me kohë të pjesshme) në kompaninë P2M Coffee Ltd, periudha e punësimit 16.03.2016-14.05.2016, duke siguruar të ardhura në shumën 421 paund.*

*5. Në periudhën 12.05.2016-21.08.2016 jam punësuar pranë kompanisë Nero Holdings Ltd, duke siguruar të ardhura në shumën 3.404 paund. 6. Ndërkohë, nga data 27.05.2016 deri më datë 15.01.2017 jam punësuar pranë kompanisë Young & Brewery (nga 27.05.2016 deri me datë 21.08.2016, ka qenë punë e dytë pasi puna kryesore ishte ajo pranë kompanisë Nero Holdings Ltd), duke siguruar të ardhura në shumën 8.204 paund. 7. Në periudhën Janar 2017 - Dhjetor 2017, jam punësuar pranë Alban Travel Ltd, duke siguruar të ardhura në shumën 9.600 paund. Ndërkohë, në periudhën 07.08.2017 - 02.10.2017 kam bërë punë të dytë pranë Young & Co Brewery, duke siguruar të ardhura në shumën 2.682 paund. Në lidhje me punësimin pranë Alban Travel Ltd, sqaroj se pavarësisht se kam punuar pranë kësaj kompanie gjatë vitit 2017, deklarimi i këtij punësimi nga ana e kompanisë është bërë në vitin e ri financiar që fillon me 1.04.2018 e deri në përfundim të tij më 31.03.2019. Nga komunikimi me emailin zyrtar të kësaj kompanie, kam kërkuar sqarime në lidhje me lapsusin e konstatuar. Në përgjigje të kërkesës sime, kompania punëdhënëse ka konfirmuar se periudha e punësimit është Janar 2017- Dhjetor 2017, por për shkak të një gabimi të brendshëm në sistemin e tyre të pagesave, ashtu edhe për faktin se pagesat e paketave turistike, të siguruara nga ana ime në vitin 2017, janë bërë kryesisht në vitin 2018 e në vazhdim, të dhënat u paraqitën në HMRC gjatë vitit 2018-2019. Bashkëlidhur do të gjeni komunikimin dhe përkthimin përkatës, me e-mailin zyrtar të kompanisë Alban Travel Ltd, të datës 1 Qershor 2021, të datës 29 Shtator 2021, si dhe deklaratën e drejtorit të kësaj kompanie, e datës 29 Shtator 2021, ku konfirmohet edhe zyrtarisht gabimi i bërë. Gjithashtu, sqaroj se fizikisht ka qenë e pamundur të punoja pranë kësaj kompanie Prill/2018-Mars/2019 në një kohë që në periudhën 01.02.2018- 01.03.2019 kam qenë në Shqipëri dhe ushtroja detyrën në pozicionin Drejtor pranë Drejtorisë Rajonale të ALUIZNIT Shkodër. Të ardhura totale nga puna në Mbretërinë e Bashkuar Tetor/2015 – Dhjetor/2017, sa më sipër, rezulton në shumën totale 31.359 paund. 8. Në periudhën 15.12.2017 e deri aktualisht, kam punuar në pozicione të ndryshme pranë ish-ALUIZNIT (sot ASHK), ndërkohë që kam punuar edhe si pedagog i jashtëm në Universitetin e Shkodrës, Fakulteti i Drejtësisë. "...omissis..*

19.5 Në vijim të rezultateve të kontrollit të pasuritë Relatori, më datë 26.10.2021 anë të komunikimit elektronit i drejtohet sërisht me pyetje në lidhje me "*depozitimin e vlerës 20.000 euro në Alpha Bank në datë 05.12.2012 , burimin e krijimit të saj dhe dokumentacionin provues"*. Në përgjigje të këtyre pyetjeve z.{…} më datë 27.10.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar sqarime dhe dokumente shoqëruese si vijon: *"Në vijim të komunikimit Tuaj, ku kërkoni shpjegim në lidhje me depozitimin e vlerës prej 20.000 euro në Alpha Bank në datë 05.12.2012, burimin e krijimit dhe dokumentacionin provues, ashtu si kam sqaruar edhe pranë ILDKPKI, ri sqaroj se: Shuma prej 20.000 euro, është pjesë përbërëse e shumës totale prej 8.000.000 Lek, të depozituar nga ana ime në periudhën Maj 2011-Janar 2016, pranë Alpha Bank dhe Credins Bank. Sqaroj se të gjitha këto shuma, në vlerë totale prej 8.000.000 lek nuk kanë qenë pasuri e imja, por e prindërve të mi, të cilat janë të ardhura nga kursimet nga puna dhe aktivitetet e tyre private. Prindërit e mi, Zejnel{...} dhe Vasilika Mitro, për shkak të pamundësisë fizike të tyre dhe problemeve të vazhdueshme dhe të renda shëndetësore në këtë periudhë (2011- 2016), më kanë*

*porositur/autorizuar verbalisht për të kryer veprimet bankare, depozitime dhe transferta sipas rastit. Kjo për arsye se sipas orientimeve të mjekëve në atë kohë gjendja shëndetësore e prindërve mund të përkeqësohej dhe mund të nevojitej një ndërhyrje kirurgjikale në spitale të specializuara jashtë vendit. Pagesa për shërbimet spitalore do të bëheshin me paratë e tyre të depozituara në mirëbesim në emrin tim dhe që do të konsistonin në veprime teknike bankare për transferimin e shumave të kërkuara (Bashkëlidhur do të gjeni deklaratën noteriale nr. 1508 rep., nr. 304 kol., date 13.07.2021, të prindërve të mi që konfirmojnë sa më lart). Nga viti 2012, nëna ime Vasilika Mitro ka statusin e invalidit të plotë, ndërsa babai Zejnel{…} nga viti 2018 ka po ashtu statusin e invalidit të plotë, megjithëse në mënyrë te vazhdueshme edhe para këtij viti vuante gjithashtu nga sëmundje të rënde dhe të vazhduar. (Bashkëlidhur do te gjeni librezat i invaliditetit të plotë të tyre). Ju bej me dije se, meqenëse gjendja e tyre shëndetësore u stabilizua brenda vendit dhe nuk u bë ndërhyrje kirurgjikale jashtë shteti, ashtu si ka rezultuar edhe nga veprimet bankare, shumën totale prej 8.000.000 lekë të cilat ishin të ardhura totalisht të prindërve të mi, e kam transferuar nga llogaria ime bankare tek llogaria e nënës sime Vasilika Mitro me datë 19.01.2016. Destinacioni i kësaj shume është blerja nga ana e prindërve të apartamentit me sipërfaqe neto 48.33 m2, regjistruar në volumin 44 faqe 42, ZK 1987, në Bashkinë Lezhe, Rruga ishull Lezhe. Origjina e pasurisë është kontrata e shitblerjes nr. 2721 rep., nr. 1436 kol., datë 16.06.2021, me vlerë 47.045 euro, si dhe mobilimi i tij sipas kontratës datë 02.11.2020 në vlerën 6.643 euro. Aktualisht, duke filluar nga viti 01.01.2021 apartamenti është dhënë me qira për një afat prej 5 vitesh sipas kontratës noteriale nr. 4247 rep, nr. 2426 kol. date 28.08.2021 në shumën vjetore 4.087 euro. Burimi i krijimit të kësaj pasurie nga ana e prindërve është: 1) Te ardhura nga puna në emigracion në Greqi në vitet 1991-1995 në shumen totale prej 12.789.844 Dhrami, të konvertueshme në afërsisht 5.115.937 lek (Bashkëlidhur do të gjeni kopje të librezave të kursimit te prindërve). 2)Të ardhura nga aktiviteti i biznesit me Nr. K31410058P NIPT, në Tiranë Shqipëri, në vitet 2000-2009, në shumën totale prej 6.984.545 lek (Bashkëlidhur do të gjeni ekstraktin e regjistrit tregtar). 3) Të ardhura nga pagat të z. Zejnel{…}, për vitet Shkurt/2009- Dhjetor/2015 në shumën totale prej 1.827.578 lek (Bashkëlidhur do të gjeni Vërtetim nr. 1593 Prot., datë 08.07.2021). 4)Të ardhura nga qiratë e dy apartamenteve në pronësi në Tiranë, në vitet 2006-2016, në shumën totale prej 6.705.000 lek (Bashkëlidhur do të gjeni kontratat e qerave dhe Certifikatat e Pronësisë). 5)Të ardhurat e qirasë nga Eagle Mobile Sh.a për vendosjen e antenave, në periudhën Prill/2008 - Qershor/2013, në shumën totale afërsisht prej 30.500 euro, të konvertueshme në afërsisht 3.751.500 lek (Bashkëlidhur do të gjeni statement nga ProCredit Bank)."*

19.6 Referuar sqarimeve të mësipërm, Relatori, më datë 29.10.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar disa pyetje si vijon, ...*omissis.. "Në vijim të komunikimeve, lutemi shpjegoni se nga cila vlerë monetare përbehet shuma 8.000.000 leke e tërhequr nga llogaria juaj personale bankare dhe e transferuar tek llogaria e nënës tuaj dhe burimin e krijimit te tyre. Nëse për këtë vlere kanë shërbyer depozitat e mëparshëm bankare, lutemi identifikoni depozitën*

*përkatëse dhe burimin e krijimit të saj?"* Në përgjigje të këtyre pyetjeve z.{…} më datë 31.10.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar sqarime dhe dokumente shoqëruese.

19.7 Në vijim të rezultateve të kontrollit të pasuritë Relatori, më datë 10.11.2021 anë të komunikimit elektronit i drejtohet sërisht me pyetje si vijon, ...*omissis* "*në vijim të komunikimeve të mëparshëm më lejoni t'ju drejtohem duke kërkuar shpjegime të mëtejshme; 1.Nga ana Juaj është deklaruar para ILDKPKI se keni përfituar të ardhura nga zyra e punës në Berlin, Gjermani për vitet 2015-2016 në shume 8862 euro, si dhe puna në Londër për periudhën 2015-2017 në shumën 31359 GBP. Shumat e sipërcituar përfaqësojnë të ardhurat Neto apo Bruto? 2. A janë transferuar pjesë te këtyre vlerave monetare në Shqipëri dhe në çfarë forme? 3. Në lidhje me kontratat e qirasë me operatorin telefonik lutemi na vini ne dispozicion një kopje komform ligjit. 4. Për të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e të gjitha pasurive tuaja të deklaruara kërkojmë informacion, dokumentacion në lidhje me tatimin mbi të ardhurat e paguara." ...omissis.* Në përgjigje të këtyre pyetjeve z.{…} më datë 14.11.2021 me anë të komunikimit elektronik ka parashtruar sqarime dhe dokumente shoqëruese.

19.8 Në vijim të verifikimit të kriterit te pasurisë nga ana e Relatorit , kandidati z.{…} me anë të komunikimit elektronik, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2681/6 prot., datë 24.11.2021, ka parashtruar mbi procedurën e verifikim si vijon, ...*omissis* "*Me email-in e datës 26.05.2021 (2.46 PM), jam njoftuar se bazuar në nenin 32 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019,"Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë", në cilësinë e kandidatit për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore që lidhen me pranimin në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe për verifikimin e pasurisë dhe figurës sime. Me Vendimin nr. 218, datë 26.05.2021, Këshilli ka vendosur: "Fillimin e procedurës së verifikimit të kandidatëve për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022". Po me këtë vendim, pas shortit të hedhur, jam njoftuar se Këshilli ka vendosur që si relator të procedurës së verifikimit ndaj meje, të caktojë anëtarin, Z. Alban Toro. Bazuar në vendimin e sipërcituar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, kam plotësuar dhe të dorëzuar personalisht, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e njoftimit të datës 26.05.2021 në zyrën e posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit. Me email-in e datës 01.06.2021 (12.28 PM), jam njoftuar lidhur me detyrimin për plotësimin dhe dorëzimin e formularëve, autorizimeve dhe deklaratave, kjo me qëllim fillimin e procedurave të verifikimit të pasurisë dhe figurës. Nga ana ime, sipas afateve dhe përpara autoriteteve të përcaktuara, është dorëzuar dokumentacioni i kërkuar. Aktualisht deri sot më datë 23.11.2021 nuk është marrë Vendim si dhe nuk kam informacion në lidhje me ecurinë e procedurës së verifikimit ndaj meje pranë KLGJ, në cilësinë e*

*kandidatit për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës. Bazuar në sa më sipër si dhe duke mirëkuptuar e respektuar kushtet dhe ngarkesën Tuaj të punës apo institucioneve ndërvepruese, do ju lutesha për një përgjigje në lidhje me procesin e verifikimit dhe vendimmarrjes pasi Shkolla e Magjistraturës ka filluar mësimin që në datën 04.10.2021 për të gjithë kandidatët dhe po afron muaji Dhjetor pa një vendimmarrje." ...omissis.*

20. Krahas administrimit të raportit të ILDKPI-së dhe sqarimit të dhënë nga kandidati në lidhje me procedurën e verifikimit të kriterit të pasurisë, për kandidatin {…}, u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

20.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10493/1 prot., datë 25.06.2021, ku për kandidatin {…} jepet e dhëna se ai është regjistruar në organet tatimore të tatimpaguesve të mëdhenj (Drejtoria Tatimore Tatimpaguesve të Mëdhenj) për ushtrim funksioni publik si administrator më datë 30.01.2018, ndërkohë që nga Drejtoria Tatimore Tatimpaguesve të Mëdhenj, me Shkresën nr. 7577/1 prot., datë 07.09.2021, u dërgua informacion për kandidatin se është regjistruar si administrator për subjektet, Drejtorinë Vendore ASH-Kamëz-Vorë dhe Drejtorinë Vendore ASHK Shkodër.

20.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 10356/1 prot., datë 30.06.2021, nga ku rezultoi se nga kandidati {…}, referuar kërkimit në sistemin ASYCUDA, është kryer një procedurë doganore importi më datë 12.07.2013 në D.D. Durrës. Nga ana tjetër, jepet informacion për personin e lidhur me kandidatin, sipas të cilit nga ana e saj është kryer një procedurë doganore importi më datë 04.08.2014 nga D. D Tiranë.

**21. Të dhënat e rezultuara si më sipër nga proçesi i verifikimit të pasurisë nuk iu nënshtruan vlerësimit të Këshillit, pasi prej këtij të fundit, pas komunimimit të gjetjeve kandidatit lidhur me figurën, sikundër do të arsyetohet në vijim, u vlerësua se, bazuar në rezultatin tërësor të hetimit administrativ, mosplotësimi në rastin konkret vetëm i kriterit të figurës, passillte skualifikimin e kandidatit.**

22. Bazuar në aktet që janë depozituar në dosjen e kandidatit, Këshilli vlerëson se kriteret e kandidimit për magjistrat të përcaktuara nga dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore të nxjerra në pajtim me të, duhet të plotësohen secila dhe të gjitha së bashku, në mënyrë që kandidati të vijojë procedurën e pranimit në programin e formimi fillestar për në Shkollën e Magjistraturës parashikuar nga nenet 28 dhe 32 e vijues i Ligjit të sipërcituar. Mos plotësimi i vetëm njërit prej tyre shkakton skualifikimin e kandidatit. **Në rastin konkret mosplotësimi i kriterit të figurës shkaktonte skualifikimin e kandidatit, pa qenë e nevojshme vlerësimi i njëkohshëm i kriterit të pasurisë.**

**C. Për kriterin e figurës**

23. Për kandidatin {…} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit, sipas të cilës: *"1. Kandidatët me rezultatet më të larta në listën e publikuar, sipas përcaktimeve të nenit 31, të këtij ligji, të cilët mund të pranohen në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, i nënshtrohen verifikimit të plotë të ... figurës".*

24. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {…}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

25. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {…} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

26. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {…}, iu kërkua dhe plotësoi e depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 04.06.2021, formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

27. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 2287/1 prot., datë 09.07.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2619/1 datë 12.07.2021, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe për kandidatin {…} pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

28. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) sipas shkronjës "c", pika 14, e këtij vendimi, si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {…} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", duke konkluduar se kandidati- *ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 04.06.2021; - formulari është regjistruar me numrin unik 000570; - vetëdeklarimi është bërë publik, në faqen zyrtare web të KLGJ-së; - në formular, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuar me ligj; - ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme, emrin "Almpert" dhe mbiemrin "Spachiou"; -nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e*

*gjendjes civile, nuk kanë rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme".*

29. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {…}, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 924/25 prot., datë 08.09.2021, protokolluar me aktin nr. 2674/1, datë 08.09.2021, përgjigjet zyrtare të 22 (njëzet e dy) prokurorive. Gjithashtu, mbi kërkesën e Këshillit, u administrua dhe përgjigja e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcjellë me Shkresën nr. 6161/1 prot., datë 03.09.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3785/1, datë 07.09.2021.

29.1 Referuar përmbajtjes së informacionit të administruar për kandidatin {…} nga Prokuroria e Përgjithshme, përcjellë me Shkresën nr. 924/25 prot., datë 08.09.2021, në bazë të përgjigjes së përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër me shkresën nr. 4667/1 prot., datë 08.07.2021, rezulton që ndaj tij të jenë regjistruar procedimet penale si më poshtë:
*"omissis.....Më datë 12.02.2019 është regjistruar procedimi penal nr. 212 për veprën penale parashikuar nga neni 186/1 dhe 248 i Kodit Penal, në lidhje me kallëzimin e bërë ndaj shtetasit {...} etj. Në këtë procedim nuk rezulton të jetë regjistruar emri i shtetasit {...}, në listën e personave që i atribuohet vepra penale. Më datë 02.12.2020 është bërë kërkesë për pushimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*
*-Më datë 27.11.2018 është regjistruar procedimi penal nr. 2035 për veprën penal e parashikuar nga neni 259 dhe 248 të Kodit penal, në emër dhe në ngarkim të shtetasit {...}, për të cilin është bërë kërkesa për pushim e çështjes më datë 22.02.2021. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 1077 (1726) datë 23.03.2021 është vendosur pranimi i kërkesës për pushimin e çështjes....."*.

29.2 Bazuar në informacionet e grumbulluara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, relatori në rrugë elektronike i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër më datë 16.09.2021, me objekt "kërkesë për informacion" në lidhje me vendimin gjyqësor me nr. 1077(1726), datë 23.03.2021 me gjyqtar Arbër Çela me objekt : "Pushimin e procedimit penal nr. 2035 viti 2018" për veprën penale "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", ku u kërkua informacion nëse ky vendim ka marrë formë të prerë apo jo, dhe nëse është bërë ankim në Gjykatën e Apelit. Në rrugë elektronike si dhe me shkresë zyrtare më datë 22.09.2021, protokolluar në Këshill me aktin nr. 2681/5 prot., referuar kërkesës Gjykata e Shkallës së Parë Shkodër, ka informuar se :"*...omissis..Në lidhje me vendimin gjyqësor me nr. 1077(1726) datë 23.03.2021 me gjyqtar Arbër Çela me objekt "Pushimin penal nr. 2035 viti 2018" për veprën penale "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", konkretisht: Nëse ky vendim ka marrë formë të prerë apo ka ankim, si dhe përcjelljen e tij, ju informojmë si më poshtë:*

*Vendimi nr. 1077(1726) date 23.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka marrë formë të prerë me datë 28.04.2021. Në të tilla kushte ju përcjellim kopje të skanuar të këtij vendimi. Njëkohësisht kopje tij zyrtare do ju përcillet në rrugë postare , në adresën e Këshillit.. omissis* ".

30. Referuar përmbajtjes së informacionit të administruar për kandidatin {…} nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përcjellë me Shkresën nr. 6161/1 prot., datë 03.09.2021, nuk rezulton që ndaj tij të jetë regjistruar procedim penal.

31. Ndërkohë, gjatë shqyrtimit të rezultateve të verifikimit, në mbledhjen plenare të datës 21.07.2022, Këshilli, në kuptim të nenit 32 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë" i ndryshuar (Kreu VI, Seksioni ,Ç pika 11.), konstatoi dhe vlerësoi se nga materialet e dosjeve gjyqësoreve të administruara në kuadër të kësaj procedure, rezultonin gjetje në procedurën e verifikimit të figurës së kandidatit, njoftuar kandidatit me shkresën protokolluar nr.2428/2 prot., datë 26.07.2022, afati i së cilës ishte 5 ditë, nga dita e marrjes së njoftimit, për paraqitjen e shpjegimeve dhe dokumenteve mbështetëse.

31.1 Në shkresën nr.2428/2 prot., datë 26.07.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor ndër të tjera në njoftimin e gjetjes, Këshilli njoftoi kandidatin si vijon : *"Në kuadër të kryerjes së procedurave të verifikimit për rekrutimin e kandidatëve për magjistratë (profili gjyqtar), mbështetur në nenin 32 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve si dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë", kryen verifikime ndër të tjera edhe në lidhje me figurën e tyre.*
*Qëllimi, ratio, i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (neni 32) , është që nëpërmjet verifikimit nga organet ligj zbatuese kandidatët e ardhshëm për profilin gjyqtar të kenë integriteti moral të lartë, si ushtrues të drejtpërdrejtë të pushtetit gjyqësor në funksion të dhënies së drejtësisë. Ky mekanizëm do ti shërbejë rritjes së pavarësisë, efiçencës dhe efikasitetit të sistemit gjyqësor dhe për rrjedhojë, përmirësimi i cilësisë së dhënies së drejtësisë dhe forcimi i besimit të publikut tek drejtësia. Gjykatat dhe gjyqtarët ushtrojnë funksionet në mënyrë të pavarur duke vlerësuar faktet dhe interpretuar ligjin sipas bindjes së brendshme të tyre. Gjatë ushtrimit të funksionit, gjyqtarët duhet të jenë të lirë nga çdo ndikim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë nga do palë dhe për çdo arsye. Gjyqtarët nuk duhet të krijojnë kontakte të papërshtatshme dhe nuk duhen të ndikohen nga pushteti ekzekutiv apo pushteti legjislativ. Gjyqtari ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykime. Këto vlera themelore të cilat duhet të mbart figura e një magjistrati gjyqtar, garantojnë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.*

*Në funksion të përzgjedhjes së kandidateve për magjistratë (profili gjyqtar), të cilat duhet të mbartnin vlera dhe cilësi të larta themelore në drejtim, të integritetit të tyre profesional dhe moral, Këshilli i Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 32 të Ligjit nr. 96/2016 realizon procedure e verifikimit të pasurisë dhe figurës së çdo kandidati,(profile gjyqtar), fitues i pranuar në programin fillestar në Shkollën e Magjistraturës.*

*Në vijim të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit tuaj për t'u emëruar si Magjistrat Gjyqtar, ju njoftojmë për gjetjen e kësaj procedure në lidhje me verifikimin e figurës, në kuptim të nenit 32 të ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë", i ndryshuar.*

*Gjatë procedurës së verifikimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 08.09.2021, Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë me Shkresën nr. 924/25 prot., datë 08.09.2021 përgjigjet zyrtare të 22 (njëzet e dy) prokurorive lidhur me informacion e kërkuar për kandidatet e formimit fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022. Në përgjigje të kësaj shkrese është administruar dhe informacioni i përcjellë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, me shkresën nr. 4667/1 prot., datë 08.07.2021, në të cilin rezulton që ndaj kandidatit {...} të jetë regjistruar procedime penale si më poshtë;*

*- Regjistrim i procedimit penal nr. 2012, më datë 12.02.2019 për veprën penale parashikuar nga neni 186/1 dhe 248 i Kodit Penal, në lidhje me kallëzimin e bërë ndaj shtetasit {...} etj. Më datë 02.12.2020 është bërë kërkesë për pushimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.*

*- Regjistrim i procedimit penal nr. 2035, më datë 27.11.2018 për veprën penal e parashikuar nga neni 259 dhe 248 të Kodit penal, në emër dhe në ngarkim të shtetasit {...}, për të cilin është bërë kërkesa për pushim e çështjes më datë 22.02.2021. Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 1077 (1726) datë 23.03.2021 është vendosur pranimi i kërkesës për pushim e çështjes etj.*

*Në regjistrimin e procedimit penal të sipërcituar me Vendimin nr.1189, datë 05.12.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ndër të tjera është vendosur: "Pranimi i kërkesës. Autorizimin e përgjimit të numrit të telefonit {...} në përdorim të shtetasit {...} në lidhje me procedimin penal 2035/2018..omissis..".*

*Nga proces verbali mbi transkriptin e bisedave telefonike të datës 18.11.2019 rezultojnë që ju të keni komunikuar me numra të ndryshëm telefonike ku me një pjesë të tyre duket sikur keni kompromentuar detyrimet për të respektuar rregullat e etikës në administratës publike përcaktuar nga Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikes në Administratën Publike", duke përfshirë :*

- *a- të kryej detyrat, në përputhje me legjislacionin në fuqi;*
- *b- të veprojë në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike ndaj vendimeve ose veprimeve ligjore të autoriteteve të administratës publike;*

*c- në kryerjen e detyrave duhet të jetë i ndershëm, i paanshëm, efikas, duke pasur parasysh vetëm interesin publik;*

*ç - të jetë i sjellshëm në marrëdhënie me qytetaret që u shërben, dhe me eproret, koleget e vartësit e tij;*

*d- nuk duhet të veprojë arbitrarisht në dem të një personi ose organizate dhe duhet të tregojë respektin e duhur, për të drejtat dhe interesat personale të të tretëve;*

*dh- të mos lejoj që interesat e tij private të bien ndesh me pozitën e tij publike, të shmang konfliktet e interesave dhe të mos shfrytëzojë asnjëherë pozitën për interesin e tij privat;*

*e- të sillet gjithnjë në mënyrë të tillë, që besimi i publikut në ndershmërinë, paanshmërinë dhe efektivitetin e shërbimit publik të ruhet e të rritet;*

*ë- të ruaj konfidencialitetin e informacionit, që ka në zotërim, por pa cenuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8503, date 30.6.1999, "Për te drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"*

*Referuar sa më lart, Këshilli, në mbledhjen plenare të datës 21.07.2022, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë" i ndryshuar (Kreu VI, Seksioni ,Ç pika 11.) vendosi që ju* ***të ftoheni të paraqisni shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si edhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit tuaj...omissis".***

31.1.1 Bazuar në njoftimin dhe vendimin e datës 26.07.2022 të Këshillit, për kandidatin {…} në lidhje me gjetjen në procedurën e verifikimin të figurës, me aktin nr.3332/1 prot., më datë 29.07.2022, aktin nr.3332/2 prot., më datë 29.07.2022 dhe aktin nr.3332/3 prot., më datë 01.08.2022 kandidati parashtroi kundërshtimet e gjetjeve si vijon:...omissis... "*Më datë 26.07.2022, ora 13.30, pranë protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, mua {...}t, më është vënë në dispozicion shkresa juaj nr. 2428/2 Prot., datë 26.07.2022, me lëndë: "Njoftim për gjetje në procedurën e verifikimit të figurës", ku jam ftuar të paraqes shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si dhe të çdo dokumentacioni mbështetës mbi transkriptin e bisedave telefonike të datës 18.11.2019. Kjo, pasi, sipas gjetjeve, duket sikur kam kompromentuar detyrimet për të respektuar rregullat e etikës në Administratë Publike përcaktuar nga Ligji nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike". Kësisoj, më lejoni që në vijim të paraqes shpjegimet e mia lidhur me gjetjet e konstatuara nga ana juaj.*

*Së pari, konstatohet se prova e marrë (procesverbali i transkriptimit të përgjimeve telefonike) ndaj të cilës jam ftuar të jap shpjegime nuk disponohet e plotë dhe me gabime në transkript, pasi në shumë raste Oficeri i Policisë Gjyqësore nuk e ka transkriptuar të gjithë fjalinë duke e lënë atë përgjysmë, çka mund t'i japë një kuptim tjetër bisedës, ndërsa në një rast ka përdorur shkurtime etj., çka të lë të nënkuptosh se mund të jetë bërë një përmbledhje, duke bërë që potencialisht të ketë edhe transformime të kontekstit dhe kuptimit të bisedës. Nisur nga fakti se gjetjet e mësipërme*

*lidhen me disa komunikime telefonike të përgjuara në kuadër të një procedimi penal, më lejoni të nënvizoj parimin e gjithë pranuar në jurisprudencë se nga përgjimi telefonik, si një nga mjetet procedurale të kërkimit të provës, shpesh, përftohen komunikime, të cilat, nëse shkëputen nga konteksti dhe rrethanat e zhvilluara, apo nëse nuk transkriptohen siç duhet fjalë për fjalë, por në mënyrë të përmbledhur (siç mund të jetë rasti konkret), dhe mbi të gjitha, nëse nuk çmohen në harmoni me prova të tjera mbështetëse, mund të krijojnë një përfytyrim të gabuar të faktit, duke sjellë përfundime të interpretueshme dhe të pasakta. Vlerësoj se gjatë komunikimeve të lira telefonike, siç janë edhe ato të përgjuara, nga ana ime edhe mund të jenë përdorur fjalë apo shprehje, që jo domosdoshmërisht duhet të merren si të thëna në kuptimin e parë të tyre, pasi në shumë raste, siç çdokujt i ndodh, janë përdorur terma në zhargon, të cilat duhen interpretuar vetëm në kontekstin e bisedës. Prandaj, nënvizoj se kuptimi i vërtetë i fjalëve apo termave të përdorur duhet të nxirret vetëm nga kontesktualizimi i bisedave në të cilat janë artikular, e që do te shpjegohen në vijim nga ana ime si burim origjinal i tyre....*

*Me anë të shkresës tuaj nr. 2428/2 Prot., datë 26.07.2022, kërkoni shpjegime për gjetjet në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në Administratën Publike". Mirëpo, e ndjej për detyrim të bëj disa sqarime rreth referimit të veprës penale bërë nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, dhe kallëzimin e bërë nga shtetasi Gjon Delijaj, që i vlerësoj të nevojshme, pasi në të kundër mund të krijohet përfytyrimi i gabuar rreth figurës time. Referimi penal bërë nga Oficeri i Policisë është një referim jo korrekt, jo profesional, tendencioze, dhe në kufijtë e abuzimit me detyrën, kjo pasi: Së pari, në referim citohet se un paskam një djalë teze që qenka sekseri im. Kjo është kryekëput e pavërtete dhe me përmbajtje dashakeqëse, pasi un nuk kam as teze dhe as hallë (bashkëlidhur do të gjeni certifikatën e trungut familjar nga nëna dhe nga babai).*

*Së dyti, mënyra e referimit të veprës penale është dukshëm tendencioze dhe dashakeqëse pasi në kallëzimin e bërë nga subjekti Delijaj aludohet ose ngrihen hipoteza se dosjet merren në mënyrë klienteliste. Ndërsa, te referimi që bën Oficeri i Policisë Gjyqësore. citohet subjekti Delijaj por duke shtuar fjalë që vetë subjekti kallëzues nuk i ka thënë p.sh. "vetëm për arsye korruptive", "Arsyet janë korruptive". Kjo vërtetohet edhe nga thëniet e subjektit kallëzues në ri pyetjen e tij, të pasqyruar edhe në vendimin e pushimit të çështjes nr. 1077(1726), datë 23.03.2021, ku ai shprehet se ka dyshime rreth kësaj akuze, prova nuk ka, këto duheshin hetuar nga prokuroria. Pra, ai në asnjë moment nuk ka pasur pretendime që objekti i tij nuk legalizohet për shkak të aferave korruptive. Së treti, bindja për një referim tendecioz dhe me përmbajtje të rreme krijohet edhe nga fakti se nga hetimi 3 mujor zhvilluar nga prokuroria me metoda proaktive nuk rezultoj asnjë veprimtari e jashtëligjshme zhvilluar nga ana ime.....omissis".*

31.1.2 Bazuar në shpjegimet e kandidatit dhe në mënyrë të veçantë në pretendimin e tij se "*procesverbali i transkriptimit të përgjimeve telefonike nuk disponohet e plotë dhe me gabime në transkripte..omissis*", Këshilli më datë 13.09.2022 mori vendim për administrimin e bisedave

telefonike të datës 18.11.2019, të lidhura me procedimin penal nr.2035, të vitit 2018 dhe verifikimin e tyre, duke i kërkuar organeve të procedimit kopje të tyre.

31.1.3 Në seancën e datës 10.10.2022, nga ana e Këshillit u dëgjua cd-ja me përgjimet telefonike sipas të dhënave të transkripteve pjesë e dosjes gjyqësore të administruar, nga u konstatua se transkriptet përputheshin plotësisht me bisedat e regjistruara në cd dhe pretendimi i ngritur nga kandidati se transkriptet nuk ishin të plota dhe se oficeri i policisë gjyqësore nuk e kishte transkriptuar drejt bisedën e përgjuar, nuk qëndronin. Pas njohjes me provën e kontestuar nga kandidati dhe konstatimit se procedura e transkriptit të kryer nga organi procedues ishte e plotë, e saktë dhe pa gabime, Këshilli në vijim të Mbledhjes Plenare me dyer të mbyllura, vendosi që, në përputhje me nenin 32 të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve si dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë", si dhe nenin 87 të Kodit të Procedurës Administrative "*Njoftimi dhe dëgjimi i palëve*", të thërrasë në seancë dëgjimore kandidatin në mënyrë që ky i fundit të mund të parashtrojë pretendimet e tij në funksion të realizimit sa më mirë të mbrojtjes së interesave të tij si dhe të shpjegimit të kontekstit të bisedave telefonike.

31.2 Në seancën e datës 14.10.2022 kandidati u paraqit në seancën degjimore duke parashtruar mbrojtjen e tij. Në fjalën e tij z.{…} bëri një prezantim të përgjithshëm të punësimit të tij duke e nisur fjalinë si vijon ..omissis.. "*në përgjithësi është krijuar ideja që drejtorët e ALUIZNI-t emërohen politikisht"* dhe duke vijuar me mënyrën e konkurrimit për këtë pozicion, e më pas vijimin e detyrës si Drejtor i komanduar pranë ALUIZNI-t Shkodër. Në fjalën e tij z.{…} parashtroi vështirësitë në drejtimin e kësaj drejtorie dhe problematikat që kishte hasur, të cilat ai i kishte parashtruar në Drejtorinë e Përgjithshme si dhe dorëheqjen e tij si drejtor i komanduar, e cila nuk ishte pranuar nga kjo e fundit "*me arsyetimin sepse për të gjithë problematikat që unë kisha ngritur do të mbështetesha nga Drejtoria e Përgjithshme*." Në fjalën e tij ai shprehet se: *omissis... "Në vijim, në vitin 2018, nga qeveria shqiptare është krijuar platforma e bashkëqeverisjes dhe në kuadrin e platformës së bashkëqeverisjes ka filluar edhe turi i llogaridhënies në të gjithë Republikën e Shqipërisë, edhe në Qarkun e Shkodrës. Janë bërë shumë takime, në të gjitha bashkitë e Qarkut Shkodër, në shumicën dërmuese të njësive administrative dhe në shumë fshatra apo zona të tjera. Pjesëmarrësit në këto takime kanë qenë banorë të zonave, të cilët kryesisht ngrenin shqetësime në lidhje me problematikën e tyre që hasin në përditshmërinë. Pjesëmarrës në këto takime... pra organizatorë dhe pjesëmarrës kanë qenë kryesisht anëtarë të Këshillit të Ministrave, kryesisht ishin 2 ose më shumë ministra, por edhe banorë të zonave. Përgjithësisht këto takime, në zhargon janë konsideruar si takime partiake, duke qenë se merrnin pjesë dy ose me shumë ministra. Por në fakt ato nuk kanë qenë mbledhje partiake, kanë qenë thjesht një nismë e qeverisë shqiptare për të dhënë llogari para banorëve. Në këtë kontekst, në zhargon është përdorur shpesh termi "mbledhje partie", kur në fakt ato s'kanë qenë fare mbledhje*

*partie. Ato kanë qenë thjesht tur llogaridhënës, dhe gabimi im i vetëm në përgjimet që kanë dalë është sepse kam përdor termin "mbledhje partie", kur në fakt duhet të kisha përdor në biseda të lira telefonike, nuk kam përdor terminologjinë e saktë, duhet të kisha thënë, fjala vjen "në mbledhjen e fundit të turit llogaridhënës, në kuadrin e bashkëqeverisjes", por kam përdorur zhargonin që përdoret rëndom dhe kam thënë "mbledhje partie" Gjithashtu, unë përveç këtyre partive, kam zhvilluar edhe takime të tjera me grupe të ndryshme interesi, ku të gjithëve iu kam kërkuar të njëjtën gjë: listën e personave që pretendojnë për të legalizu objektet e tyre, me të dhëna të tjera teknike. Pra në rastin konkret kemi një konfondim të turit llogaridhënies në kuadër të platformës së bashkëqeverisjes me mbledhjen e partisë, pra ashtu siç e shpjegova, ka qenë thjesht një term zhargon.... omissis."*

Kandidati parashtroi se legalizimet i kishte kryer konform ligjit dhe se në asnjë moment nuk kishte qenë i ndikuar politikisht. Kandidati shpjegoi se qëllimi i bisedave telefonike kishte qenë për të mbledhur informacion me qëllim kryqëzimin e tij për të ndërtuar një plan pune. Kandidati u shpreh: " *..... omissis Unë thjesht kam mbledh informacion, kam kërku për të marrë informacion dhe këtë informacion, ideja ka qenë që të kryqëzohet me informacione të tjera dhe të krijohej një plan pune. Vetë ky proces përmban kosto edhe kohore por edhe kosto ekonomike që askush nuk e merr përsipër për ta bërë. Vetë ALUIZNI duke pas shumë kapacitete dhe duke pas edhe eksperiencë në këtë punë, e ka shumë të vështirë për me mbledh informacionet që unë i kam kërku E.. Pra kjo ka ngel thjesht në kuadrin e një bisede që isha shumë i sigurt që ky nuk do ta zbatonte.....Tani lidhja e partive politike në procesin e legalizimit është pothuajse zero. Pra metodika e punës është e tillë që krijohen kritere objektive për nxjerrjen e dosjeve për punë dhe në vijim qëllimi final është përmbyllja e procesit të legalizimit, dhe personalisht kam pas edhe si qëllim kapjen e normativave. .... omissis."* duke vijuar fjalën e tij me përshkrimin e eksperiencës 10 vjeçare të punës dhe mos pasjen e asnjë mase disiplinore por vetëm vlerësime maksimale në performancës e tij.

Gjatë seancës dëgjimore nga ana e Anëtarëve të Këshillit i janë drejtuar pyetje kandidatit në lidhje me ndërtimin e politikave të pretenduara prej tij për trajtimin e kërkesave, duke i kërkuar shpjegime për rëndësinë që kishin listat e kërkuara prej tij në bisedat e përgjuara në trajtimin e kërkesave për legalizim si dhe për mënyrën se si ishte punësuar stafi i tij vartës për të cilin në bisedat telefonike dukej se jepte llogari e vlerësime në drejtues politikë me të cilët kishte komunikuar. Në përgjigje të pyetjes së parë nga ana e kandidatit është dhënë një përgjigje e njëjtë referuar sqarimeve të gjetjes si dhe shpjegime teknike të procesit të legalizimit në disa zona kadastale edhe pse pyetja ishte fokusuar tek thelbi pse ishin të nevojshme telefonatat me të gjithë kryetarët e njësive administrative për kërkimin e listave. Në përgjigje të pyetjes së dytë lidhur me punësimin e stafit vartës kandidati u shpreh se ai nuk kishte asnjë rol në punësimin e tyre, por sipas fjalës së tij ai mund të këtë "*propozu diçka*", por vetëm lidhur me performancës e tyre çdo gjashtë muaj. Lidhur me vazhdimin e përgjigjes për raportimin e këtyre performancave të cilat lidheshin me punën e vartëseve tek drejtuesit politikë, ai shprehet se *omissis...* "*Inxhinieri konkret është një i njohuri i përbashkët, edhe të kryetarit të Bashkisë së Malësisë së Madhe edhe i imi. Pra kemi qëllu të*

*njohur... Po nuk e raportova. Ishte thjesht një bisedë, bisedë shoqërore. Nuk ishte raportim. Ai më pyeti për specialistin. I dhashë shpjegimin që performanca e tij është shumë e dobët. .... omissis."*

Kandidati u pyet lidhur me bazën ligjore për ndërtimin e prioriteteve në legalizime, në kushtet kur në komunikimet e tij telefonike përmendeshin "*lista me prioritet*". Kandidati u përgjigj: *"omissis... Edhe një herë. E para, nuk ka një procedurë dhe një rregullim, as të brendshëm, as ligjore dhe as me VKM. Pra është në diskrecionin e ALUIZNI-t për me dhënë prioritet zonave të caktuara ose kategorive të caktuara.... omissis."* Kandidatit iu kërkua gjithashtu shpjegime lidhur me trajtimin e vetëdeklarimeve të individëve sipas kohës së paraqitjes së tyre si dhe dhënies së përparësisë sipas një liste që e kërkonte nga drejtuesit e njësive administrative, sikundër ai shprehej në bisedat telefonike "*sipas orjentimeve në mbledhjen e partise*". Në përgjigje të kësaj pyetje kandidati u përgjigj: *"omissis... Po mirë, mbase edhe jam shpreh gabim. Kam kërku informacion nga zonat e terrenit. Ky është kryetar i njësisë administrative. Ky përfaqëson terrenin. Kam kërku informacion. Është edhe në rregulloren e brendshme, pika 11 e rregullores "Organizon punën për mbledhjen e informacionit të nevojshëm nga njësitë e qeverisjes vendore që përfshin në juridiksionin territorial administrativ të saj, të nevojshëm për ecurinë e procesit dhe bën grupimin e informacionit". Pra unë thjesht kam kërku informacion. Nuk është se këtë informacion që unë kam marrë këtu do ta merrsha shabllon dhe do t'i jepja prioritet. Ato do përpunoheshin prapë nga specialistët e terrenit; do bëhej një plan pune se cilat objekte janë të banume, cilat jo, cilat janë vetëdeklarime të 2005-ës, brenda gjithmonë bllokut kadastral dhe do vijojë punën pastaj sipas planit të punës.... omissis."* Ndërsa lidhur me përdorimin e termit *"në vazhdën e mbledhjes së fundit që kena ba te partia*" kandidati shpjegoi: *"omissis... Edhe një herë, gabimi im i vetëm është sepse nuk kam përdorur, edhe në biseda të lira telefonike, terminologjinë e saktë ligjore. Duhet të kisha thënë "Në takimin e fundit të turit llogaridhënës në kuadrin e bashkëqeverisjes". I kam rënë shkurt, kam thënë "mbledhje partie.... omissis."*

## III. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI I REZULTATEVE TË VERIFIKIMIT TË FIGURËS

32. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {…} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat konkludohet se për të ekzistojnë shkaqe të qenësishme për ta skualifikuar dhe për të ndaluar procedurën e mëtejshme të verifikimit me qëllim pranimin në formimin fillestar për në Shkollën e Magjistraturës sa i përket kriterit të figurës, duke pasur parasysh përcaktimet e shkronjës "c", pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, sipas së cilës: *"4/1. Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të .. figurës kur: ...; b) kandidati ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar;* ***c) ka shfaqur sjellje të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë****; …".*

33. Konkretisht, nga hetimi administrativ rezulton se në kuadër të një procedimi penal në ngarkim të kandidatit është administruar edhe *proces verbali mbi transkriptin e bisedave telefonike që i përket procesit teknik të përgjimit në zbatim  të Vendimit nr.1189, datë 05.12.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër i lidhur me procedimin penal nr. 2035, të vitit 2018.*

33.1 Në komunikimet e kandidatit me numra të ndryshëm telefonike rezulton se kandidati kërkonte lista prioritetesh legalizimesh duke iu referuar detyrave të ngarkuara nga *"mbledhjet e fundit që u ba tek Partia"* apo diskutime në lidhje me mosveprimin apo paaftësinë e specialisteve të administratës në varësi të tij me funksionarë të partive politike të qeverisjes vendore në kundërshtim të hapur me Ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikes në Administratën Publike".

34. Fillimisht, duke u ndalur tek roli kushtetues i KLGJ, ky i fundit vlerëson se, për shkak të funksionit që kryen, përmbush të gjitha garancitë kushtetuese konform standardeve të pranuara ndërkombëtarisht për t'u kualifikuar si një organ publik që ushtron funksione *"quasi-gjyqësore"* në drejtim të veprimtarisë së tij në kuadër të vlerësimit të kritereve për emërimin e gjyqtarëve, duke qenë në sensin substancial "*gjykatë e krijuar me ligj*" në kuptim të nenit 6 të KEDNJ. Vlerësimi i kritereve ligjore për emërimin e gjyqtarëve, është pjesë e një procedure administrative, e cila vepron si parakusht i domosdoshëm në procesin e emërimit dhe, si e tillë, kjo procedurë duhet të garantohet përmes procesit të rregullt ligjor. Për shkak të këtij strukturimi kushtetues që i është bërë KLGJ-së, ky organ gëzon autoritetin kushtetues dhe ligjor për të vepruar si *"shkallë e parë gjykimi"*, lidhur me çështjen e përmbushjes së kushteve dhe kritereve për emërimin e gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë. Në procesin e verifikimit të kritereve për emërimin e gjyqtarëve, Këshilli, njëlloj si gjykata, ka detyrimin të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. I gjithë procesi administrativ që bën Këshilli është një verifikim nga e para që Këshilli i bën ndër të tjerash edhe figurës së kandidatit, duke pasur autoritetin ekskluziv të dhënë nga ligji për të vendosur përfundimisht lidhur me këtë çështje.

35. Këshilli vlerëson të evidentojë se në një shtet demokratik të sunduar nga ligji gjyqtari përmbush një funksion shumë të rëndësishëm, atë të sigurimit e të zbatimit të normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe akteve të tjera ligjore, të garantimit të shtetit të së drejtës dhe të mbrojë të drejtat dhe liritë e njeriut. Drejtësia përfaqëson një komponent esencial të shoqërisë demokratike. Ajo synon të zgjidhë konfliktin ndërmjet palëve nëpërmjet vendimeve të cilat kanë një rol të dyfishtë "normative"dhe "edukative" duke i mundësuar publikut të marrë informacion, njohuri dhe siguri për atë që ligji rregullon dhe zbatimin konkret të tij. Gjykatat konsiderohen si vendi i duhur për të mbrojtur të drejtat, respektuar detyrimet e zgjidhur konflitet. Roli dhe funksioni i Gjykatës është që nëpërmjet vendimeve të transformojë dispozitat ligjore nga abstrakte-metafizike, në substanciale dhe konkrete, duke i garantuar mbrojtje situatave juridike në të cilat ndodhen individët dhe garantuar në këtë mënyrë shtetin e së drejtës. Në këtë kontekst publiku ka

një pritshmëri të lartë në pushtetin gjyqësor si vendi i fundit ku ata gjejnë mbrojtje për të drejtat e tyre.

35.1 Kjo pasi vendimi gjyqësor synon të japë efekte sigurie për individin dhe të konfirmojë se shoqëria drejtohet nga ligji, promovon dhe mbron të drejtat e individit si edhe interpreton ligjin në mënyrë të pavarur. Në këtë kuadër, mosrespektimi i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj, mund të përbëjë shkak për cënimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Referuar *"teorisë së dukjes"*, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por edhe duhet të shihet. **Në këtë kuptim, vlerësohet se ka rëndësi se çfarë veprimesh ka bërë një gjyqtar në përmbushje të detyrës së tij, por është e rëndësishme gjithashtu të vlerësohet se çfarë shoqëria mendon. Në këtë kuptim, sjellje të caktuara të gjyqtarit konsiderohen si cënim i parimit të besimit të publikut tek drejtësia.**

35.1.1 Pikërisht për të përmisuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, ky i fundit iu nënshtrua një reforme drastike ligjore. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të ligjeve të paketës për reformën në drejtësi, standardi i vendosur në kuadër të kësaj reforme, në lidhje me verifikimin e pasurive dhe integritetit moral e profesional, përfshiu jo vetëm trupën e magjistratëve, por edhe të aspiranteve apo kandidatët për t'u pranuar në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët synonin për t'u bërë pjesë e kësaj trupe gjyqësore.

35.1.2 Ligji i posaçëm, Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", në nenin 32 ka përcaktuar procedurë të detajuar si edhe burimet e provës me anë të së cilës kandidatët që konkurrojnë për t'u pranuar e vijuar studimet në formimin fillestar të magjistraturës si gjyqtar, do të duhet t'i nënshtrohen kontrollit, ndër të tjera, jo vetëm të pasurisë duke analizuar në lidhje me të vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues **por edhe vlerësimin etiko moral e profesional të kandidatit si magjistrat (neni 32/4.1 parag c)**. Ky nen jo vetëm mbart garanci për respektimin e interesit publik por ai është perfshirë nga ligjvënësi për shkak të nevojës dhe domosdoshmërisë që mbart integriteti si element thelbësor i funksionit të magjistratit.

35.2 Për shkak të natyrës së funksionit që kryen në shoqëri, integriteti i magjistratit është më shumë se virtyt, është një domosdoshmëri, sepse besimi i publikut tek institucionet e drejtësisë nuk varet vetëm nga profesionalizimi i tyre, por edhe nga integriteti moral. Magjistrati ose kandidati për magjistrat, i cili është subjekt që së shpejti pritet të jetë pjesë e sistemit të drejtësisë duhet që gjithmonë dhe jo vetëm gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, por kurdoherë të sillet me nder dhe të jetë i virtytshëm që të kontribuojë në rritjen e besimit të qytetarëve tek sistemi, profesionistët e sistemit të drejtësisë dhe të jetë në gjendje që të ofrojnë besueshmëri.

35.2.1 Për t'iu rikthyer analizës së provave të administruara gjatë hetimit administrativ për kandidatin nën optikën e kritereve të përcaktuara nga ligji i posaçëm mbi pritshmëritë që publiku ka për ata që do të jenë pjesë e trupës gjyqësore, rezulton se veprimet e kandidatit gjatë marrëdhënies së punës si Drejtori i ish Aluiznit Shkodër janë kompromentuese dhe dëmtojnë besimin e qytetarëve tek sistemi i drejtësisë. Kandidati po konkurron për figurën e gjyqtarit të cilën ligji por edhe kontrolli i figurës dhe i pasurisë, e kërkon të pa cenuar dhe me integritet të pastër. Ndërkohë, ai ka qenë i detyruar të respektonte legjislacionin në fuqi dhe në menyrë të veçantë detyrimet e përcaktuara nga Ligji Nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike". Ky ligj përcakton një tërësi rregullash dhe standarde që ndihmojnë sa punonjësit e administratës publike në kryerjen e detyrave të tyre dhe performancën e institucionit, aq edhe qytetarët në forcimin e besimit të tyre ndaj institucioneve publike, duke qenë kështu një vlerë e shtuar në legjislacionin e të drejtës publike në vend. Në të janë përfshirë parimet më të rëndësishme të Kodit të Procedurave Administrative (KPA) të cilat të adresojnë në ligjshmërinë, paanësinë, eficencën dhe transparencën.

35.2.2 Për shkak të respektimit të këtij ligji kandidati gjatë marrëdhënieve të mëparshme të punës duhej të mos ishte i ndikuar politikisht, pasi paanësia politike buron nga pluraliteti politik që qëndron në themel të shtetit dhe që e konsideron të papranueshëm që ndikimi politik të konvertojë në listë prioritesh, sipas *"mbledhjes së fundit të ba tek partia"*, miratimin e lejeve të legalizimit në dëm të qytetarëve që janë jashtë atij ndikimi. Të ishte i ndershëm, i paanshëm, efikas, i sjellshëm në kryerjen e detyrës kryesisht me qytetarë të cilëve u ofron shërbimin, kërkesë e natyrshme që reflekton faktin që administrata duhet të jetë dhe të mbetet publike, në themel të së cilës është shërbimi ndaj qytetarit, të mos veprojë arbitrarisht në dëm të një personi/organizate dhe të tregojë respekt për të drejtat/interesat personale të të tretëve, duke mos i kthyer marrëdhëniet e punës në raporte shërbimi tek përfaqësuesit e drejtuesve politikë lokalë (faqe nr.2 (*Item 379*) e procesverbalit).

35.3 Analiza për mënyrën se si nëpunësit publik duhet të normojnë sjelljen profesionale dhe personale në funksion të ruajtjes së besimit të publikut, për shkak të rëndësisë themelore që ajo ka për ekzistencën dhe funksionimin e shtetit të së drejtës, përfshin veprimet ose mosveprimet që mund të perceptohen si favorizuese ndaj palëve procedurale (përfaqësuesve lokalë apo qendrorë të partive politike) ose me standarde të dyfishta, në respektimin e pronës por, mbi të gjitha të ligjit, të cilin ai duhet ta respektojë dhe mbrojë.

36. Ky vlerësim për kandidatin është pasojë e vlerësimit të Këshillit se si veprimet dhe mosveprimet e demonstruara prej tij gjatë ushtrimit të detyrës dhe jashtë saj, **shihen nga një vëzhgues i pavarur dhe vlerësohen prej qytetarëve në drejtim të funksionimit të shtetit ligjor,** duke krijuar pakënaqësi dhe cenim të besimit të publikut. Ky model sjellje "*me ndikim dhe i varur nga politika*" është i papranueshëm në një shtet demokratik dhe qartësisht nuk kontribuon në

kthimin e besimit të publikut tek Institucionet Publike dhe aq më pak tek sistemi i riformuar i drejtësisë shqiptare.

36.1. Në vështrim të nenit 6/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon: "*Ndalohet zgjedhja, emërimi apo ushtrimi i një funksioni publik në një nga organet e parashikuara në këtë Kushtetutë, ose të krijuara me ligj, pavarësisht përcaktimeve të bëra në dispozitat e tjera të kësaj Kushtetute, nëse verifikohen rrethana që cenojnë integritetin e funksionarit publik, sipas kushteve dhe rregullave të përcaktuara me ligj të miratuar me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit*.", përcaktohet një kufizim esencial i cili synon të garantojë integritetin, i cili është qenësor për veprimtarinë e mirëfilltë të një kandidati për magjistrat, kjo pasi gjyqtari mbart detyrimin të zbatojë dhe gëzojë standarde të larta të integritetit. Integriteti i tij është kriter për të përcaktuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe për rrjedhim kandidati për magjistrat, duhet të ketë cilësi dhe të sillet në atë mënyrë që afirmon besimin e publikut dhe integritetin e sistemit të drejtësisë. Në rastin "de qua" konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të kandidatit për magjistrat në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin, **apo edhe më keq i përulur ndaj presionit politik në formën e realizimeve të listave të prioriteteve të lejeve të legalizimit, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë tek publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë në të ardhmen.**

37. Në nenin 32, pika 4 të Ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R.Shqipërisë" parashikohet se: " *Këshillat vendosin që kandidati nuk kalon procesin e verifikimit të pasurisë dhe figurës kur : .....c)* ***ka shfaqur sjelle të rënda të papërshtatshme etike dhe morale që cenojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë***...". Bazuar në këtë këtë parashikim ligjor, Këshilli edhe më parë ka vlerësuar se, në kuptim të verifikimit të kriterit të figurës së kandidatit dhe vlerësimit për pranueshmërinë ose jo të një kandidati për në formimin filletar për magjistrat në Shkollën e Magjistraturës është edhe etika dhe morali <u>në çdo sjellje të evidentuar në të kaluarën e tij,</u> për të cilat Këshilli ka për detyrë të verifikojë dhe vlerësojë nëse ato janë në përputhje me vlerat themelore të një magjistrati, standardet etike dhe rregullat e sjelljes, të përcaktuara këto në nenet 3 dhe 4 të Ligjit të Statusit.[3] Këto sjellje etike dhe morale që të passjellin skualifikimin e kandidatit, duhet të jenë të rënda në atë masë sa të cënojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor. ***<u>Besimi i publikut mund të cenohet sa herë që ekziston një arsye për të vënë në dyshim integritetin e funksionarit publik, i cili ushtron një autoritet publik (në periudhën kur është në shërbim në një funksion/detyrë publike</u>***<u>).</u> Në rastet kur ish/funksionari publik është një nga kandidatës fitues të SHM për trajnimin fillestar profili gjyqtar, autoriteti vendimmarrës për verifikimin e figurës së tij, është Këshilli, pavarësisht vlerësimit të sjelljes së kandidatit nga institucionit ku ai ka qenë i punësuar gjatë kohës kur ka ushtruar funksionin/detyrën publike.Vlerësimet e këtyre institucioneve sigurisht që janë të rëndësishme në drejtim të verifikimit të sjelljeve dhe etikës së kandidatit, por vendimmarrja në fund i takon Këshillit. Në

[3] Vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor Nr. 250 dt. 04.11.2019.

rastin e kandidatit {…}, edhe pse nga institucioni ku ai ka qenë i punësuar nuk ka pasur të dhëna për procedime disiplinore, nga procesi i verifikimit ka rezultuar se gjatë kohës kur ai ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë së ALUIZN-it (funksion shtetëror në shërbim të publikut), në detyrën e drejtorit të këtij institucioni ndaj tij ka pasur të regjistruar procedim penal të filluar pikërisht për veprime të kryera për shkak të detyrës. Pavarësisht se ky procedim nuk ka përfunduar me vendime fajësie për kandidatin, analiza e veprimeve apo mosveprimeve të tij si dhe i sjelljes së kandidatit gjatë ushtrimit të detyrës shtetërore, objekt të këtij procedimi penal, ishin të nevojshme të bëheshin nga ana e Këshillit në drejtim të verifikimit të figurës së kandidatit.

38. Në rastin konkret nga të dhënat e administruara gjatë procesit administrativ të verifikimit dhe konkretisht nga dëgjimi i bisedave telefonike dhe përmbajtja e njëjtë e transkripteve pjesë e dosjes gjyqësore në lidhje me procedimin penal Nr. 2035/2018, rezulton se kandidati dukshëm nuk shfaq dy nga vlerat themelore të gjyqtarit, pavarësi dhe paanshmëri në funksion. ***Për Këshillin nuk ka rëndësi nëse kandidati i ka dhënë realisht përparësi listave të kërkuara "sipas orjentimeve të partisë" apo sipas kërkesave të kryetarit të bashkisë. Mjafton predispozita e tij për trajtimin e kërkesave për legalizim mbi baza partiake që e bën atë të mos shfaqë garancitë që shteti ligjor e besimi i publikut kërkon për gjyqtarin.***

## IV. KONKLUZIONE

39. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z.{…}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

40. Bazuar në sa më lart është parashtruar, mbi rezultatet e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {…}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati **nuk përmbush një nga këto kritere, pikërisht atë të figurës, shkak për të cilin, bazuar në shkronjën "c", pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është vendi për skualifikimin / ndalimin e kandidimit të tij për në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2021-2022.**

## PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 4/1, shkronja "c" dhe pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja "ë" dhe në nenin 97, pika 1, shkronja "a", të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja

“a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

**VENDOSI:**

1. Skualifikimin e kandidatit z. {…}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2021-2022.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {…}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

3. Kandidati ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**